

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës me të dhënat si në vijim:

Titulli i pozitës:	SHTËPIAK/E (DY POZITA)
Numri i referencës:	KON062025
Kohëzgjatja e emërimit:	Kontratë me afat të caktuar (me mundësi vazhdimi)
Puna provuese:	Tre (3) muaj
Adresa:	Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë e shtëpiakes/shtëpiakut:

- Mirëmbajtjen e plotë të brendshme dhe të jashtme të zyrës së FKPK-së, duke përfshirë:
 - Mirëmbajtjen e dyshemeve, dyerve dhe dritareve.
 - Mirëmbajtjen e tavolinave dhe mobilie të tjera të zyrës.
 - Mirëmbajtjen e nyjave sanitare dhe hapësirave ndërlidhëse.
 - Mirëmbajtjen e kuzhinës.
 - Përkujdesjen për higjienën e përgjithshme në objekt.
- Siguron se zyra e FKPK-së është e pastër dhe e rregullt në vazhdimësi.
- Detyra të tjera që mund të përcaktohen nga DM dhe Bordi Drejtues, ose Procedurat në fuqi.

Kriteret e konkursit

Përvoja:	Përvojë së paku pesë vjeçare në kryerjen e detyrave të ngjashme.
Edukimi:	Së paku diplomë të shkollës së mesme.
Gjuha:	Gjuha shqipe. Njohuria e gjuhëve tjera do të jetë përparësi. Njohuri për kimikatet dhe materialet e pastrimit.
Aftësitë:	Aftësia për të punuar me pajisje të ndryshme për pastrim e mirëmbajtje (nëse kërkohet). Aftësi (gjendje) e mirë fizike. Aftësi të shkëlqyera ndër personale.

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

Konkursi është i hapur prej 11 prillit e deri më 1 maj 2025, ora 16:00 (CET).

Konkurrimi bëhet përmes postës elektronike (e-mail) në: recruitment@trusti.org duke e vendosur si titull: "**Konkurs për Shtëpiak/e**", dhe duke i bashkëngjitur dokumentet në vijim (në formatin pdf): **1)** Jetëshkrimin (CV-në); **2)** Diplomën e shkollës së mesme (e skanuar) **3)** Referenca që e mbulojnë përvojën.

VËMENDJE! Aplikacionet pa bashkëngjitur "Dokumentet për aplikim" si dhe ato të dorëzuara pas afatit, NUK do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit do të kontaktohen.